



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVIIZIJA KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

## **Thirrje për Shprehje Interesi**

### **Ofrim shërbimesh të specializuara, përpilim i planit ideor për ndërtesën e Radio Televizionit të Kosovës përmes kompensimit me hapsirë reklamuese**

#### **Autoriteti Kontraktor**

Radio Televizioni i Kosovës

Adresa: rr. Xhemajl Prishtina nr.12, Prishtinë, Kosovë

Tel: +38138 230102

Radio Televizioni i Kosovës i ka parashtruar kërkesë Ministrisë së Administratës Publike për marrjen e tokës në shfrytëzim për ndërtimin e ndërtesës së Radio Televizionit të Kosovës. Ministria e Administratës Publike përmes shkresës me Nr.2936 të datës 13.10.2017 ka njoftuar Radio Televizionin e Kosovës se mundet të bënë planifikime për akomodim në lokacionin Prishtina e re (afër Pallatit të Drejtësisë) ku është e dedikuar për ndërtimin e agjencive qeveritare dhe është e rregulluar me plan urbanistik të aprovuar në KK Prishtinë.

Në shërbime të specializuara nënkuptojmë përpilimin e planit ideor për ndërtesën e Radio Televizionit të Kosovës dhe përpilimin e maketës së ndërtesës së Radio Televizionit të Kosovës.

Kompania e cila do të ofron këtë shërbim duhet të jetë Kompani e kualifikuar për këtë shërbim respektivisht të jetë Byro e arkitekturës e cila ka përvojë pune në përpilimin e planeve ideore për ndërtesa.

Plani ideor dhe maketa e ndërtesës së Radio Televizionit të Kosovës duhet të përfundoj më së largu me 20.12.2017.

Marrë parasysh se përpilimi i planit ideor dhe maketës së ndërtesës së Radio Televizionit të Kosovës do të mbulohet përmes hapsirës reklamuese, Kompania me ofertë më të favorshme do të përzgjedhet si fituese e projektit.

#### **Afati për dorëzimin e Ofertës**

Dorëzimi i Ofertës “Plani ideor për ndërtesën e Radio Televizionit të Kosovës”, mund të bëhet prej datës **13 Nëntor 2017 deri më 17 Nëntor 2017, deri në orën 16:00.**

Ofertat **duhet të dorëzohen personalisht**, në kovertë të mbyllur, në ndërtesën e RTK-Televizionit të Kosovës, Rr. Xhemajl Prishtina 12, 10000 Prishtinë.